

Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Shqipëri

Cili është qëllimi?

- ▶ forcimi i aftësisë së vendim-marrësve për të adresuar mbrojtjen dhe promovimin e pakicave kombëtare, mbrojtjen e të drejtave LGBTI dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes në përputhje me standardet dhe rekomandimet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës - veçanërisht ato të Komisionit Evropian për Racizmin dhe Intolerancën (ECRI) dhe nga Komiteti Këshillëdhënës i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM).
- ▶ projekti synon gjithashtu të mbështesë negociatat e pranimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në fushën e mbrojtjes së të drejtave themelore.

Kush përfiton nga Projekti?

- ▶ qytetarët e Shqipërisë
- ▶ autoritetet publike, veçanërisht organet që punojnë në fushën ebarazisë
- ▶ profesionistët e arsimit, studentët
- ▶ media
- ▶ organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Si do të funksionojë projekti?

- ▶ në nivelin politik dhe legjislativ, duke mbështetur autoritetet për të përmirësuar përputhshmërinë e legjisllacionit
- ▶ në nivelin e ngritjes së kapaciteteve, duke përmirësuar vënien në zbatim të dokumenteve strategjike dhe ligjeve përkatëse, monitorimin e tyre, grumbullimin dhe analizën e të dhënave
- ▶ duke rritur nivelin e ndërgjegjësimit ndaj rreziqeve të paraqitura nga gjuha e urrejtjes
- ▶ duke forcuar bashkëpunimin dhe sinergjitë ndërmjet organeve të barazisë në Ballkanin Perëndimor dhe/ose institucioneve kombëtare të së drejtave të njeriut, si dhe ndërveprimin e tyre me organizatat e shoqërisë civile
- ▶ duke garantuar një qasje me të fokusuar ndaj çështjeve gjinore

Çfarë pritet të arrijë?

- ▶ përmirësim në zbatimin e politikave dhe legjisllacionit në fushën e anti-diskriminimit, në nivel qendror dhe vendor (veçanërisht për të drejtat e personave LGBTI dhe për luftimin e gjuhës së urrejtjes/krimeve të urrejtjes);
- ▶ nxitje në dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- ▶ rritje e nivelit të ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe mekanizmat për t'i mbrojtur ato

Së fundmi, mbrojtje më e mire e të drejtave të njeriut për qytetarët e Shqipërisë dhe ndërtim të një shoqërie me më diversitet, barazi dhe tolerancë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

Sa do të kushtojë?

- ▶ buxheti total i projektit është 400.000 EUR
- ▶ buxheti i caktuar në total ndaj programit të Instrumentit Horizontal është baras me rreth 41 milionë EUR (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës)

Si të përfitohet më shumë informacion?

- ▶ Këshilli i Evropës, faqja e internetit e Departamentit të Anti-Diskriminimit: www.coe.int/antidiscrimination
- ▶ mediat sociale: www.facebook.com/coeantidiscrimination
- ▶ Faqja e internetit e Instrumentit Horizontal: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Iva Çoku, Oficere Projekti, Iva.COKU@coe.int, +355 69 558 6499
- ▶ Marija Simić, Oficere Komunikimi e Instrumentit Horizontal, Marija.SIMIC@coe.int, +381 63 601 337
- ▶ Besnik Baka, Oficer Komunikimi i Instrumentit Horizontal, Besnik.BAKA@coe.int, +355 69 217 8430

Rreth Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u mundëson përfituesve të përmbushin agjendat e tyre të reformës në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe përputhjen me standardet evropiane, duke përfshirë aty ku është e nevojshme çështjet në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar mbulon projekte në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi, si dhe në Kosovë * dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës prej majit 2019.

**Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimin në lidhje me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.*

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

www.europa.eu

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës